



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KUVENDI

Komisioni për Çështjet Ligjore, Administratën Publike dhe të Drejtat e Njeriut

Dokument parlamentar

PROCESVERBAL

Datë 17.03.2015, ora 09:00

Drejton mbledhjen:

Fatmir Xhafaj – kryetar i Komisionit

Rendi i ditës:

Projektligji “Për ratifikimin e protokollit të Marrëveshjes së Stabilizim-Asociimit ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe komuniteteve evropiane dhe shteteve të tyre anëtare në kuadër të anëtarësimit të Republikës së Kroacisë në Bashkimin Evropian”.

Marrin pjesë:

Fatmir Xhafaj, Oerd Bylykbashi, Armando Subashi, Bashkim Fino, Blendi Klosi, Vasilika Hysi, Dashamir Peza, Ulsi Manja, Petrit Vasili, Pandeli Majko, Vexhi Muçmataj, Silva Caka, Arben Ristani, Eduard Halimi, Gent Strazimiri, Tahir Muhedini, Fatmir Mediu, Nard Ndoka, Xhemal Qefalia.

Mungojnë:

Tom Doshi, Mhill Fufi

Të ftuar:

Gentian Elezi – zëvendësministër i Integrimit Evropian.

Altin Fuga – përfaqësues i Ministrisë së Integrimit Evropian.

HAPET MBLEDHJA

Fatmir Xhafaj – Mirëmëngjes!

Në këtë mbledhje komisioni do të kemi vetëm një çështje në rendin e ditës, projektligjin “Për ratifikimin e protokollit të Marrëveshjes së Stabilizim-Asociimit ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe komuniteteve europiane e shteteve të tyre anëtare në kuadër të anëtarësimit të Republikës së Kroacisë në Bashkimin Europian”, një projekt marrëveshje kjo e cila do të shqyrtohet ditën e enjte, dhe nuk do të ketë gjë tjetër për shkak të ngarkesës së kësaj dite me aktivitete të tjera parlamentare dhe mungesës së opozitës.

Lidhur me këtë projektligj është i pranishëm zëvendësministri i Integritetit Europian, zoti Gentian Elezi.

Mirë se keni ardhur!

Në mos gabo, është hera e parë që jeni në Komisionin e Ligjeve dhe është për t’ju thënë “Me këmbë të mbarë”! Në rregull.

Fillimisht do të kemi një prezantim nga zëvendësministri dhe pastaj do të vazhdojmë me pyetje dhe diskutime, nëse do të ketë.

Përpara se ta marrë fjalën zoti zëvendësministër...

(Kryetari i komisionit flet pa mikrofon.)

Ju lutem, zoti Elezi, na jepni një përmbledhje të shkurtër të projekt marrëveshjes.

Gentian Elezi – Faleminderit, zoti kryetar!

Mirëdita të gjithëve!

Ministria e Integritetit Europian ka koordinuar procesin e përshtatjes teknike të Marrëveshjes së Stabilizim-Asociimit ndërmjet Shqipërisë dhe Bashkimit Europian pas anëtarësimit të Kroacisë, proces i bërë edhe më parë në rastin e anëtarësimit të Rumanisë dhe të Bullgarisë, pasi me anëtarësimin e këtyre vendeve lind nevoja që të ketë një përshtatje të marrëveshjes dhe një ndryshim të saj për të mos prekur tregtinë tradicionale midis vendit që anëtarësohet dhe Shqipërisë. Kjo ka ndodhur edhe me anëtarësimin e Kroacisë, pra është rinegociuar të themi ajo pjesë e Marrëveshjes që do të duhej të rregullonte marrëdhëniet midis dy vendeve dhe është arritur në një përfundim, duke ndryshuar vetëm disa aspekte teknike të saj, të cilat garantojnë që aksesin dhe tregtia midis dy vendeve të jetë e pandryshuar.

Siç e thashë, kjo është diçka gati rutinë, sepse është një negociatë që bëhet sa herë anëtarësohet një vend i ri dhe kjo është pikërisht çfarë ka ndodhur edhe kësaj radhe.

Fatmir Xhafaj – Faleminderit, zoti Zëvendësministër!

Ka pyetje nga kolegët?

Është marrëveshje standarde, por gjithsesi më duhet të pyes: a ka pyetje? Nuk ka pyetje. Ka diskutime? Nuk ka.

Kur bëhet fjalë për BE-në, paska konsensus absolut.

Kush është dakord në parim? Dakord.

Kalojmë në votimin nën për nën.

Neni 1? Dakord.

Neni 2? Dakord.

Kush është dakord në tërësi? Të gjithë pro. Kundër? Nuk ka. Abstenim? Nuk ka.

Miratohet.

Faleminderit!

E mbyllim këtu mbledhjen e komisionit. Projektligji i kalon seancës plenare për ditën e enjte.

Faleminderit, zoti Zëvendësministër!

Faleminderit të gjithëve dhe ditë të mbarë!

Nesër nuk ka mbledhje komisioni.

MBLEDHJA MBYLLET